



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORT VJETOR

MBI VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË KRU- ve

NË BAZË TË PËRMBUSHJES SË CAQEVETË PËRCAKTUARA ME PROCESIN RREGULLATOR TË VITIT 2010

Periodha e shikuar: 1 Janar – 31 Dhjetor 2010

Punuar nga:
Departamenti për Financa dhe Tarifa Rregullatore (DFTRR), ZRRUM

Prishtinë, Gusht 2011

Parathënie

Ky raport pasqyron të dhënat e performances së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit, me të cilën vlerësohet përmbushja e caceve të përcaktuara me procesin rregullatorë për vitin 2010 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit që i përket periudhës së shikuar.

Raporti përmban të dhënat për çdo kompani veç e veç dhe pastaj pasqyron të dhënat e tërë sektorit.

Raporti është përgatit mbi bazën e të dhënave të deklaruara të kompanive në Departamentin e Performances (DP) në ZRRUM, sipas projektit të mbledhjes së të dhënave të Sistemit të Raportimit Financiarë, Operativ dhe të Shërbimeve për Konsumatorë (ROFK) dhe raportimit të dhënave të investimeve kapitale projekt për projekt në Departamentin e Financave dhe Tarifave Rregullatore (DFTRR), ZRRUM.

Të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë raport janë të audituara nga ZRRUM, gjatë procesit të auditimit/verifikimit të të dhënave për të gjitha KRU-të në Kosovë.

Përmbajtja

1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT.....	4
1.1. Paraqitja grafike për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve	6
2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE	8
2.1. Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit	12
2.2. Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të	13
3. ANALIZA E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË VLERË MONETARE	14
3.1. Paraqitja grafike e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për KRU-të	17
4. INVESTIMET KAPITALE	19
4.1. Investimet e realizuara gjatë vitit 2010	19
4.2. Krahësimi i Investimeve Kapitale me caqet e përcaktuara nga ZRRUM	22
4.2. Paraqitja grafike e investimeve kapitale	23
KONKLUSIONE	25

1. ANALIZA E PRODHIMIT DHE FATURIMIT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit: (I) uji i prodhuar në metër kub, (II) uji i humbur apo i pa faturuar në metër kub, (III) uji i faturuar në metër kub, (IV) ujërat e zeza të faturuara; (V) numrin e konsumatorëve.

Së pari këto të dhëna do të paraqiten në formë tabelore të sistemuara në tri kolona ku do të paraqiten të dhënat historike për vitin 2009, të dhënat e aprovuara nga ZRRUM 2010 dhe të dhënat e realizuara për vitin 2010 dhe në dy kolona tjera është paraqitur % përmbushjes/mosëpërmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtarë për vitin 2010.

Tabela Nr. 1 Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar, ujërave të zeza të faturuara, numrin e konsumatorëve, % dhe vlerësimi përfundimtarë

Emri i Kompanisë	Të dhënat	Njësia	Historike 2009	Aprovuara 2010	Realizuar a 2010	Ndryshimi në %	Vlerësimi përfundimtar 2010
Prishtina	Uji i prodhuar	M ³	45,105,379	45,720,000	45,804,238	0.18	Pozitiv
	Uji i humbur		24,214,078	19,011,900	25,091,969	31.98	Negativ
	Uji i faturuar		20,891,301	26,708,100	20,712,269	-22.45	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		18,024,492	22,968,966	17,812,551	-22.45	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	86,491	72,289	92,525	27.99	Pozitiv
Mitrovica	Uji i prodhuar	M ³	17,358,593	16,580,000	17,699,162	6.75	Pozitiv
	Uji i humbur		8,895,248	7,379,499	9,374,852	27.04	Negativ
	Uji i faturuar		8,463,345	9,200,501	8,324,310	-9.52	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		3,890,980	4,394,384	4,016,600	-8.60	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	21,314	20,080	21,386	6.50	Pozitiv
Hidrodrini	Uji i prodhuar	M ³	28,192,459	30,000,000	28,898,061	-3.67	Negativ
	Uji i humbur		20,908,029	22,320,129	20,815,247	-6.74	Pozitiv
	Uji i faturuar		7,284,430	7,679,871	8,082,814	5.25	Pozitiv
	Ujërat e zeza të faturuara		3,531,182	3,993,533	4,203,063	5.25	Pozitiv
	Numri i konsumatorëve	Nr	30,896	30,065	33,384	11.04	Pozitiv
Radoniqi	Uji i prodhuar	M ³	15,162,287	17,225,068	17,598,576	2.17	Pozitiv
	Uji i humbur		8,366,236	8,247,566	10,726,266	30.05	Negativ
	Uji i faturuar		6,796,051	8,977,502	6,872,310	-23.45	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		4,186,142	4,991,491	3,821,004	-23.45	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	27,230	27,783	28,018	0.85	Pozitiv
Hidroregjioni Jugor	Uji i prodhuar	M ³	15,244,976	12,057,815	16,122,541	33.71	Pozitiv
	Uji i humbur		8,420,885	4,142,913	9,378,796	126.38	Negativ
	Uji i faturuar		6,824,091	7,914,902	6,743,745	-14.80	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		6,278,163	7,377,930	6,286,228	-14.80	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	31,230	28,195	32,707	16.00	Pozitiv
Bifurkacioni	Uji i prodhuar	M ³	5,088,640	6,536,459	5,869,435	-10.20	Negativ
	Uji i humbur		2,910,484	2,782,820	3,551,505	27.62	Negativ
	Uji i faturuar		2,178,156	3,753,639	2,317,930	-38.25	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		1,742,525	3,202,469	1,977,574	-38.25	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	13,694	18,750	16,057	-14.36	Negativ
Hidromorava	Uji i prodhuar	M ³	6,937,500	9,038,000	7,462,760	-17.43	Negativ
	Uji i humbur		3,954,319	3,614,712	4,481,900	+23.99	Negativ
	Uji i faturuar		2,983,181	5,423,288	2,980,860	-45.04	Negativ
	Ujërat e zeza të faturuara		2,684,862	4,989,425	2,742,391	-45.04	Negativ
	Numri i konsumatorëve	Nr	16,676	17,422	18,200	4.49	Pozitiv

Të dhënat e aprovuara nga procesi rregullatorë i vitit 2010 janë ato të dhëna të cilat janë akorduar me KRU-t dhe të dhënat e realizuara për vitin 2010 janë të dhëna të dala nga afarizmi i KRU-ve për këtë vit. Në dy kolonat tjera është paraqitur (%) përmbushjes/mospërmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtarë për vitin 2010.

Shpjegim:

Vlerësimi i DFTRR/ZRRUM konsiston në këtë kalkulim: kolona “Ndryshimi në %” paraqet diferencën në mes kolonës “Realizuara 2010” me kolonën “aprovuara 2010”.

E vetmja kompani që ka katër indikatorë pozitivë është KRU “Hidrodrini” sh. a. Pejë, ndërsa katër të tjera kanë nga dy indikatorë pozitivë, një e ka një dhe një tjetër se ka asnjë indikatorë pozitivë.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave sektoriale për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuara, ujërave të zeza të faturuara dhe numrin e konsumatorëve, % dhe vlerësimin përfundimtarë

Të dhënat për sektorin	Njësia	Historike 2009	Aprovuara 2010	Realizuara 2010	Ndryshimi në %	Vlerësimi përfundimtar
Uji i prodhuar	m ³	133,089,834	137,157,342	139,454,773	1.68	Pozitiv
Uji i humbur		77,669,279	67,499,539	83,420,535	+23.59	Negativ
Uji i faturuar		55,420,555	69,657,803	56,034,238	-19.56	Negativ
Ujërat e zeza të faturuara		40,338,346	51,918,198	40,859,412	-21.30	Negativ
Numri i konsumatorëve	Nr	227,531	214,584	242,282	12.91	Pozitiv

Shembull për sqarimin e metodologjisë së përdorur për të vlerësuar performancën e vitit 2010;

Rast specifik është “uji i humbur”. Gjatë procesit tarifor 2009-2011 DFTRR/ZRRUM së bashku me KRU-të ka miratuar politikën tarifore dhe në kuadër të kësaj ka përcaktuar metodologjinë e zvogëlimit të sasisë së ujit të humbur nga viti në vit, pasi që uji i humbur përbën njërin ndër caqet kryesore të Performances së KRU-ve.

P.sh.: KRU “Prishtina” Sh. a – Prishtinë është zotuar që për vitin 2010 të ketë 19,011,900 m³ ujë të humbur. Mirëpo gjatë vitit 2010 pas auditimit të të dhënave nga ZRRUM, është konstatuar se uji i humbur i shprehur në m³ për këtë kompani është konstatuar të jetë 25,091,969 m³. Diferenca nga e dhëna e realizuar me atë të aprovuar për ujin e humbur është 6,080,069 m³, e cila kur të shprehet në raport me ujin e humbur të aprovuar dhe të paraqitet në përqindje rezulton se kjo kompani ka humbje të ujit prej 31.98 % në krahasim me sasinë e përcaktuar me procesin rregullatorë të vitit shikuar.


Në mënyrë analoge për të gjitha KRU-të aplikohet i njëjti kalkulim për vlerësimin e cakut të përcaktuar gjatë procesit tarifor për vitin 2010.

Nga të dhënat e tabelave të theksuara më lartë shihet se shumica e kompanive kanë trende negative të realizimit të caqeve të përcaktuara nga rregullatori. Trende pozitive mund të identifikohen te prodhimi i ujit tek disa kompani dhe te shtimi i numrit të konsumatorëve të shërbyer. Por, është evidente se caqet kryesore të përcaktuara me procesin rregullatorë nuk janë përmbush për periudhën e shikuar një vjeçare të vitit 2010. Edhe te ato kompani ku kemi pas ngritje të sasisë së ujit të prodhuar nuk mund të kemi efekte pasi që kemi të ngritur sasinë ujit të humbur dhe mos përmbushje të cakut të përcaktuar për faturim dhe arkëtim, si rast përjashtues mund të merret “Hidrodrini”.


1.1. Paraqitja grafike për ujin e prodhuar dhe të faturuar sipas KRU-ve

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e veçanta të çdo kompanie për prodhimin dhe humbjen e ujit si dhe të dhënat sasiore të ujit dhe ujërave të zeza të faturuara dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer. Këto diagrame si të tilla nuk do të komentohen pasi që përmes tyre mund të vërehet qartë shkalla e realizueshmërisë së caqeve të caktuara nga ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 1. Prodhimi i ujit në m³




Diagrami Nr. 2. Uji i humbur në m³




Diagrami Nr. 3. Uji i faturuar në m³



Diagrami Nr. 4. Ujërat e zeza të faturuara në m³



Diagrami Nr. 5. Numri i Konsumatorëve



2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Edhe këtë grupim të dhënave do të paraqesim në formë tabelore duke i identifikuar shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza për vitin 2009 dhe vitin krahasues 2010 për caqet e përcaktuara.

Tabela numër 3. përfshin shtatë (7) kompanitë të cilat veprojnë në sektorin e ujit dhe kanalizimit, ku do të shihen shpenzimet operative në tri kolona. Kolona e parë paraqet shpenzimet historike të vitit 2009, kolona e dytë paraqet shpenzimet e aprovuara nga ZRRUM për vitin 2010 dhe kolona e tretë paraqet shpenzimet e krijuara nga kompanitë gjatë vitit 2010. Pastaj kolona e përqindjeve (%) është produkt i shpenzimeve të ndodhura nëpër kompani gjatë vitit dhe shpenzimeve të aprovuara s'bashku (KRU-ZRRUM) me procesin rregullator të vitit shikuar.

Për kolonat e të dhënave Historike për vitin 2009 dhe për kolonën e të dhënave të realizuara për vitin e shikuar 2010 të dhënat janë marrë nga DP në ZRRUM. Kurse të dhënat në kolonën Të aprovuara nga ZRRUM janë marr nga Vlerësimi përfundimtar i Aplikacionit për Tarifa i procesit tarifor për vitet 2009-2011.

Tabela Nr. 3. Pasqyra e shpenzimeve operative të aprovuara dhe realizuara gjatë vitit 2010 (ndaras për ujë dhe kanalizim)

Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	UJË					KANALIZIM				
			Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	Ndryshimi në %	Vlerës. përfund. 2010	Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	Ndryshimi në %	Vlerës. përfund. 2010
Prishtina	Stafi (personeli)	€	2,578,245	3,004,100	3,017,152	0.43	Negativ	140,200	361,600	93,314	-74.19	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	1,833,947	1,499,600	1,712,517	14.20	Negativ	7,706	39,700	7,268	-81.69	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	1,740,152	2,299,300	1,518,628	-33.95	Pozitiv	13,840	98,500	66,379	-32.61	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	6,152,344	6,803,000	6,248,297	-8.15	Pozitiv	161,746	499,800	166,961	-66.59	Pozitiv
Mitrovica	Stafi (personeli)	€	825,189	851,000	889,977	4.58	Negativ	51,372	101,000	98,166	-2.81	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	316,866	244,000	334,072	36.91	Negativ		38,000	0	-100.00	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	665,460	570,000	510,381	-10.46	Pozitiv	21,684	112,000	16,416	-85.34	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,807,515	1,665,000	1,734,430	4.17	Negativ	73,056	251,000	114,582	-54.35	Pozitiv
Hidrodrini	Stafi (personeli)	€	790,416	844,800	863,145	2.17	Negativ	41,601	100,200	45,429	-54.66	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	311,342	151,900	339,443	123.46	Negativ		0	0	0	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	328,937	524,800	266,030	-49.31	Pozitiv	15,768	46,800	12,279	-73.76	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,430,695	1,521,500	1,468,618	-3.48	Pozitiv	57,369	147,000	57,708	-60.74	Pozitiv
Radoniqi	Stafi (personeli)	€	1,198,955	1,254,700	1,230,660	-1.92	Pozitiv	85,357	94,800	85,908	-9.38	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	138,278	142,400	142,490	0.06	Pozitiv	19	0	2,678	!	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	450,905	390,900	443,368	13.42	Negativ	10,129	15,800	12,129	-23.23	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,788,138	1,788,000	1,816,518	1.59	Negativ	95,505	110,600	100,715	-8.94	Pozitiv
Hidroregjioni Jugor	Stafi (personeli)	€	856,103	834,700	973,804	16.67	Negativ	105,808	41,100	120,465	193.10	Negativ
	Energjia elektrike	€	465,098	381,800	490,601	28.50	Negativ	62,076	28,200	60,636	115.02	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	567,952	383,800	406,415	5.89	Negativ	19,203	52,500	37,681	-28.23	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,889,153	1,600,300	1,870,820	16.90	Negativ	187,087	121,800	218,782	79.62	Negativ
Bifurkacioni	Stafi (personeli)	€	345,431	225,400	361,639	60.44	Negativ	38,913	121,600	69,153	-43.13	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	32,289	17,800	59,272	232.99	Negativ		4,300	0	!	Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	147,618	195,000	125,833	-35.47	Pozitiv	5,555	137,100	16,986	-87.61	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	525,338	438,200	546,744	24.77	Negativ	44,468	263,000	86,139	-67.25	Pozitiv
Hidromorava	Stafi (personeli)	€	328,674	447,800	310,640	-30.63	Pozitiv	25,556	111,900	32,240	-71.19	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	109,685	56,500	116,487	106.17	Negativ	293	14,100	0		Pozitiv
	Shpenzimet tjera operative	€	593,359	478,600	521,784	9.02	Negativ	11,207	119,700	34,655	-71.05	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,031,718	982,900	948,911	-3.46	Pozitiv	37,056	245,700	66,895	-72.77	Pozitiv

Tabela Nr 3a., është produkt i tabelës numër 3., por dallimi është se këtu nuk janë ndarë uji dhe kanalizimi por janë paraqitur në formë të përmblendhur për të kuptuar më lehtë përmëmbledhjen e të dhënave dhe kuptuar krahasimet e bëra.

Tabela Nr. 3a. Pasqyra e përmblendhur e shpenzimeve operative për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, të aprovuara dhe realizuara gjatë vitit 2010

Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	UJË DHE KANALIZIM				
			Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	Ndryshimi në %	Vlerës. përfund. 2010
Prishtina	Stafi (personeli)	€	2,718,445	3,365,700	3,110,466	-7.58	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	1,841,653	1,539,300	1,719,785	11.73	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	1,753,992	2,397,800	1,585,007	33.90	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	6,314,090	7,302,800	6,415,258	-12.15	Pozitiv
Mitrovica	Stafi (personeli)	€	876,561	952,000	988,143	3.80	Negativ
	Energjia elektrike	€	316,866	282,000	334,072	18.47	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	687,144	682,000	526,797	-22.76	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,880,571	1,916,000	1,849,012	-3.50	Pozitiv
Hidrodrini	Stafi (personeli)	€	832,017	945,000	908,574	-3.85	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	311,342	151,900	339,443	123.46	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	344,705	571,600	278,309	-51.31	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,488,064	1,668,500	1,526,326	-8.52	Pozitiv
Radoniqi	Stafi (personeli)	€	1,284,312	1,349,500	1,316,568	-2.44	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	138,297	142,400	145,168	1.94	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	461,034	406,700	455,497	12.00	Negativ
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,883,643	1,898,600	1,917,233	0.98	Negativ
Hidroregjioni Jugor	Stafi (personeli)	€	961,911	875,800	1,094,269	24.95	Negativ
	Energjia elektrike	€	527,174	410,000	551,237	34.45	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	587,155	436,300	444,096	1.79	Negativ
	Σ e shpenzimeve operative	€	2,076,240	1,722,100	2,089,602	21.34	Negativ
Bifurkacioni	Stafi (personeli)	€	384,344	347,000	430,792	24.15	Negativ
	Energjia elektrike	€	32,280	22,100	59,272	168.20	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	153,173	332,100	142,819	-57.00	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	569,806	701,200	632,883	-9.74	Pozitiv
Hidromorava	Stafi (personeli)	€	354,230	559,700	342,880	-38.74	Pozitiv
	Energjia elektrike	€	109,978	70,600	116,487	65.00	Negativ
	Shpenzimet tjera operative	€	604,566	598,300	556,439	-7.00	Pozitiv
	Σ e shpenzimeve operative	€	1,068,774	1,228,600	1,015,806	-17.32	Pozitiv

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë të marra nga tabela nr. 3 në të cilën janë mbledhur shpenzimet operative për ujë dhe ato për kanalizim nga të cilat kemi fituar shumën e përbashkët të tyre në dy kolonat e vitit 2010 nga të cilat kanë dalë rezultatet e prezantuara kompani për kompani.

Disa karakteristika të Tabelës 3a.;

Duhet theksuar se shumën e shpenzimeve tjera operative e kanë tejkaluar vetëm KRU “Radoniqi” për 12.00% dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” për vetëm 1.79%. Kompanitë tjera nuk i kanë realizuar shpenzimet e tilla dhe kjo vlerësohet nga rregullatori si veprim jo i mirë me mundësi të zvogëlimit të bazës së vlerës së aseteve të tyre.

Shumën e përgjithshme operative të aprovuar me procesin rregullatorë 2010 nuk e ka realizuar kompania e; “Prishtinës” për 12.15%, “Mitrovicës” për 3.50%, “Hidrodrinit” për 8.52%, “Bifurkacionit” për 9.74% dhe “Hidromoraves” për 17.32%, ndërsa e ka tejkaluar ajo e “Hidroregjioni Jugor” për 21.34% dhe “Radoniqi” me vetëm për 0.98%.

Fondin e pagave të KRU “Hidrodrini” sh. a. Pejë e kemi marrë nga Plani i Biznesit 2008-2010, të janarit 2008 pasi që kemi bërë disa ndryshime te kostoja e tarifave për ti balancuar të njëjtat. Në këtë mënyrë veprohet edhe me raportet tjera të këtij viti.

Tabela numër 3b. përmban të dhënat e përmbledhura sektoriale të shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit nga e cila nxjerrim konkluzionet mbi gjendjen e këtij sektori në raport me shkallen e përmbushjes së objektivave për vitin 2010 me përmbajtjen e saj.

Tabela Nr. 3b. Pasqyra e të dhënave të përmbledhura sektoriale të shpenzimeve operative për ujë e kanalizim

Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	UJË					KANALIZIM				
		Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	ndryshimi %	Vlerës. përfund. 2010	Historike 2009	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	ndryshimi %	Vlerësimi Përfundimtar ,2010
Stafi (personeli)	€	6,923,013	7,462,500	7,647,017	2.47	Negativ	488,807	932,200	544,675	-41.57	Pozitiv
Energjia elektrike	€	3,207,505	2,494,000	3,194,882	28.10	Negativ	70,094	124,300	70,582	-43.22	Pozitiv
Shpenzimet tjera operative	€	4,494,383	4,842,400	3,792,439	-21.68	Pozitiv	97,386	582,400	196,525	-66.26	Pozitiv
Σ e shpenzimeve operative	€	14,624,901	14,798,900	14,634,338	-1.11	Pozitiv	656,287	1,638,900	811,782	-50.47	Pozitiv

Në nivel sektori në kategorinë e zërave të shpenzimeve operative për shërbimet e ujësjellësit kemi dy zëra negativ dhe dy zëra pozitivë të cilin e kemi komentuar ma lartë, ndërsa tek shërbimet e ujërave të zeza vlerësimi është pozitivë – por nga aspekti menaxherial është tejet negativë për shumë arsye. Është evidente se nga aspekti sektorial shuma e shpenzimeve tjera operative e aprovuar me procesin rregullatorë është dukshëm nën parashikime e cila në vlerë absolute i ofrohet ¼ së shumës së aprovuar dhe vlerësohet nga aspekti menaxherial si jo i mirë duke marr parasysh gjendjen ekzistuese të aseteve nëpër kompani.

Vlerësimi jonë është fokusuar tek shërbimi sektorial për ujëra të zeza edhe pse në dukje është pozitivë nga aspekti financiarë, por nga aspekti menaxherial është vlerësuar si negativë, pasi që ky shërbim duket të mos jetë i organizuar sa dhe si duhet dhe shpenzimet tjera operative janë dukshëm nën shumën e lejuar.

2.1. Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit

Në këtë tabelë përveç shpenzimeve të përgjithshme operative kemi shtuar edhe shpenzimet apo kostot e shumës së investimeve vetanake gjatë vitit 2010.

Tabela. Nr. 4. Pasqyra mbi të dhënat e mbulueshmërisë së të hyrave të arkëtuara me shpenzimet e përgjithshme operative të ndodhura gjatë vitit 2010, në këtë tabelë është futur edhe shuma e investimeve vetanake gjatë vitit 2010.

NR	Emri i Kompanisë	Arkëtimi dhe të hyrat tjera operative €	Shpenzimet Operative pa amortizim €	Mbetja Financiare €	Investimet Kapitale vetanake €	Shkalla e Mbulueshmërisë
	A	B	C	D=(B-C)	E	F=B/(C+E)
1	Prishtina	7,763,595	6,415,258	1,348,337	553,865	1.11
2	Mitrovica	1,215,047	1,849,012	-633,965	33,398	0.65
3	Hidrodrini	1,657,527	1,526,326	131,201	82,046	1.03
4	Radoniqi	1,791,583	1,917,233	-125,650	49,022	0.91
5	Prizreni	1,990,570	2,089,602	-99,032	82,826	0.92
6	Bifurkacioni	748,170	632,883	115,287	61,889	1.08
7	Hidromorava	1,098,927	1,015,806	83,121	36,656	1.04
	Të dhënat sektoriale	16,265,419	15,446,120	819,299	899,702	1.00


Nga të dhënat e dala në këtë pasqyrë mund të konkludojmë se me këtë indikatorë më së miri e ka dalë të jetë KRU “Prishtina” sh. a. Prishtinë e cila e ka shkallën e mbulueshmërisë me 1.11, ndërsa ma së keqi qëndron KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë e cila shkallën e mbulueshmërisë e ka vetëm 0.65.

Arsyeja e treguesit kaq negativë për ujësjellësin e Mitrovicës është se kompania nuk inkason as një shumë për furnizimin e ujit të trajtuar për pjesën veriore të qytetit. Por kompania për shpenzimet e saja për ta furnizuar pjesën veriore të qytetit gjatë vitit 2010 është kompensuar me një shumë të subvencionuar prej 374,030 euro, me të cilat janë paguar disa shpenzime operative.


2.2. Paraqitja grafike e të dhënave për shpenzime operative sipas KRU-të

ZRRUM nuk do ti komentoj as të dhënat grafike të paraqitura më poshtë për shpenzimet operative pasi që të njëjtat janë të qarta dhe janë komentuar pak a shumë më lartë dhe palët e interesuara mund ti nxjerrin vetë konkluzionet e veta për të dhënat e dala.

Diagrami Nr .6. Shpenzimet operative për ujë



Diagrami Nr. 7. Shpenzimet operative për kanalizim



3. Analiza e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare

Edhe të dhënat për faturimin dhe arkëtimin në vlerë monetare do të paraqiten në formë tabelare, në mënyrë që më lehtë të krahasohen rezultatet e arritura në vitin 2010 me ato të aprovuara nga ZRRUM me procesin e përcaktimit të tarifave për vitet 2009-2011. Tabela do të përmbajë edhe një kolonë me të dhënat historike për vitin 2009, e cila do të mundësojë krahasimin historik të rezultateve të arritura si për faturimin po ashtu edhe për arkëtimin.

Të dhënat historike janë marrë nga Raporti Përfundimtarë i Vlersimit të përmbushjes së objektivave të përcaktuar për vitin e përmbyllur (historik) 2009. Të dhënat për shumën e aprovuara janë marrë nga Raporti përfundimtar i përcaktimit të tarifave për secilën kompani veç e veç. Për sa u përket të dhënave të shumave në kolonën realizimit për vitin 2010 këto shuma janë marrë nga ROFK të cilat kompanitë i deklarojnë mbi bazën mujore në Departamentin e Performances/ZRRUM.

Tabela 5. ofron të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim, edhe kjo tabelë provon faktin se kompanitë janë larg nga përmbushja e objektivave të përcaktuar për këtë periudhë kohore të shikuar.

Përveç anës tekstuale dhe tabelave, të dhënat mbi efikasitetin e faturimit dhe të arkëtimit do të paraqiten edhe përmes diagrameve.

Tabela Nr. 5. Të dhënat e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për të dy shërbimet si dhe shumave nga tarifa fikse

Emri i Kompanive	Të dhënat financiare	Njësia	Faturimi dhe arkëtimi sipas dy kategorive						Σ e tarifës fikse	Σ e tarifës fikse	Σ e faturimit dhe arkëtimimit për ujë dhe kanalizim	
			Ujë			Kanalizim						
			Historike 2009	Aprovuara 2010	Realizuara 2010	Historike 2009	Aprovuara 2010	Realizuara 2010	Aprovuar 2010	Realizuar 2010	Aprovuara 2010	Realizuar 2010
Prishtina	Faturimi	€	8,074,313	11,131,900	8,752,435	724,504	1,171,400	826,675	1,040,900	1,153,417	13,344,200	10,732,527
	Arkëtimi	€	5,926,195	8,522,680	6,110,212	531,754	894,099	577,115	768,440	805,219	10,185,219	7,492,546
Mitrovica	Faturimi	€	1,592,016	1,957,900	1,519,879	233,627	301,400	216,477	284,800	297,290	2,544,100	2,033,646
	Arkëtimi	€	943,780	1,489,842	827,969	138,499	232,889	117,928	209,276	161,952	1,932,007	1,107,849
Hidrodrini	Faturimi	€	1,694,298	1,886,400	1,875,161	202,199	274,600	224,418	503,700	451,192	2,664,700	2,550,771
	Arkëtimi	€	1,254,172	1,436,184	1,110,066	149,674	209,383	132,852	372,649	267,099	2,018,216	1,510,017
Radoniqi	Faturimi	€	1,926,592	3,029,400	1,975,777	213,814	242,600	217,965	419,500	412,966	3,691,500	2,606,708
	Arkëtimi	€	1,574,226	2,270,872	1,321,360	174,708	182,095	145,771	314,099	276,183	2,767,065	1,743,314
Hidroregjioni Jugor	Faturimi	€	1,960,729	2,360,500	2,073,712	286,169	359,300	283,653	437,700	448,241	3,157,500	2,805,606
	Arkëtimi	€	1,408,606	1,754,309	1,430,319	205,586	266,659	195,646	324,177	309,169	2,345,145	1,935,134
Bifurkacioni	Faturimi	€	648,486	898,600	727,948	103,882	525,600	138,395	288,500	199,080	1,712,700	1,065,423
	Arkëtimi	€	484,667	633,896	443,610	77,640	371,875	84,338	212,381	121,319	1,218,152	649,267
Hidromorava	Faturimi	€	943,231	1,635,700	973,661	177,110	397,200	189,519	262,200	235,897	2,295,100	1,399,077
	Arkëtimi	€	707,588	1,329,990	660,582	132,864	322,272	128,579	214,080	160,045	1,866,342	949,206
Shuma e përgjithshme	Faturimi	€	16,839,665	22,900,400	17,898,573	1,941,305	3,272,100	2,097,102	3,237,300	3,198,083	29,409,800	23,193,758
	Arkëtimi	€	12,299,234	17,437,772	11,904,119	1,410,725	2,479,271	1,382,229	2,415,102	2,100,985	22,332,146	15,387,333

Në tabelën nr. 5.a. janë paraqitur shumat e faturimit dhe të arkëtimit të mbledhura edhe për ujë edhe për kanalizim. Nga kjo tabelë shihet se asnjë nga kompanitë nuk ka arritur caqet e përcaktuara nga rregullatori. Problemi i faturimit dhe arkëtimit është problem i cili në vazhdimësi përcjell kompanitë, për çka janë duke u marrë masa shtesë për përmirësimin e faturimit e sidomos të arkëtimit. ZRRUM shpreson se aktivitetet në rritje për përmirësimin e arkëtimit do të rezultojnë me një arkëtim më të mirë në të ardhmen.

Tabela Nr. 5.a.. Pasqyra e vlerësimit përfundimtar të faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare

Emri i Kompanive	Të dhënat financiare	Njësia	Faturimi dhe arkëtimi për dy shërbimet		Përqindja e realizimit të caktuar (%)	Vlerësimi përfundimtar
			Aprovuara 2010	Realizuara 2010		
Prishtina	Faturimi	€	13,344,200	10,732,527	80.43	Negativ
	Arkëtimi	€	10,185,219	7,492,546	73.56	Negativ
Mitrovica	Faturimi	€	2,544,100	2,033,646	79.94	Negativ
	Arkëtimi	€	1,932,007	1,107,849	57.34	Negativ
Hidrodrini	Faturimi	€	2,664,700	2,550,771	95.72	Negativ
	Arkëtimi	€	2,018,216	1,510,017	74.82	Negativ
Radoniqi	Faturimi	€	3,691,500	2,606,708	70.61	Negativ
	Arkëtimi	€	2,767,065	1,743,314	63.00	Negativ
Hidroregjioni Jugor	Faturimi	€	3,157,500	2,805,606	88.86	Negativ
	Arkëtimi	€	2,345,145	1,935,134	82.52	Negativ
Bifurkacioni	Faturimi	€	1,712,700	1,065,423	62.21	Negativ
	Arkëtimi	€	1,218,152	649,267	53.30	Negativ
Hidromorava	Faturimi	€	2,295,100	1,399,077	60.96	Negativ
	Arkëtimi	€	1,866,342	949,206	50.86	Negativ

Tabela 5.b., ofron të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim edhe kjo tabelë provon faktin se kompanitë janë larg nga përmbushja e objektivave të përcaktuar për këtë periudhë kohore të shikuar.

Tabela Nr .5b. Pasqyra e të dhënave sektoriale për faturim dhe arkëtim gjatë vitit 2010

Të dhënat financiare	Njësia	Faturimi dhe arkëtimi për dy shërbimet		Përqindja e realizimit të caktuar në nivel sektori (%)	Vlerësimi përfundimtar për sektorin për vitin 2010
		Aprovuara 2010	Realizuara 2010		
Faturimi	€	29,409,800	23,193,758	78,86	Negativ
Arkëtimi	€	22,332,146	15,387,333	68,90	Negativ


Shpjegim:

Duke pasur parasysh se asnjëra nga KRU-të në Kosovë nuk kanë arritur ti përmbushin caqet e përcaktuara nga DFTRR për Faturim dhe Arkëtim rregullatori e vlerëson performancën e sektorit si tejet negative dhe jo efikiente për periudhën e shikuar të vitit 2010.


3.1. Paraqitja grafike e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare për KRU-të

Në vijim do të paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare. Nga forma e tyre shihet shkalla e realizueshmërisë së objektivave të caktuara sipas marrëveshjes KRU-ZRRUM, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë kohore të vitit paraprak.


Diagrami Nr. 8. Diagrami i faturimit të ujit në vlerë monetare




Diagrami Nr. 9. Diagrami i arkëtimit në vlerë monetare për ujë



Diagrami Nr. 10. Diagrami i ujërave të zeza të faturuara në vlerë monetare



Diagrami Nr. 11. Diagrami i arkëtimit në vlerë monetare për kanalizim



4. INVESTIMET KAPITALE

Me procesin rregullatorë 2009-2011 të gjitha kompanive u janë lejuar shuma të caktuara të investimeve kapitale nga burimet e brendshme të financimit të cilat i kanë ngarkuar tarifat e viteve përkatëse dhe natyrisht që janë lejuar edhe të gjitha projektet kapitale të planifikuara për realizim nga donatorët potencial.

Nga analizat e bëra për të dhënat e mbledhura për realizim të projekteve investuese financuar nga burimet e brendshme të kompanisë, mund të konkludohet se kompanitë në përgjithësi kanë dështuar ti përmbushin objektivat e përcaktuara për periudhën e shikuar kohore.

4.1. Investimet e realizuara gjatë vitit 2010

ZRRUM i ka kushtuar rëndësi të veçantë çështjes së realizimit të Investimeve Kapitale nga burimet vetanake të kompanisë, pasi të njëjtat e kanë ngarkuar tarifën, dhe për këtë, ka organizuar vizita sistematike duke u takuar me zyrtarë kompetent të KRU-ve, prej nga edhe kanë marrë të dhënat për investimet kapitale, të cilat janë të paraqitura në pasqyrat e më poshtme tabelore.

Të dhënat e investimeve kapitale të paraqitura në tabelën e mëposhtme paraqesin të dhëna tashmë të audituara, për të cilat është bërë vizita secilës kompani dhe nga të cilat është marr pajtimi i tyre.

Janë ndërmarrë këto veprime për identifikimin e projekteve të realizuara, për secilën kompani veç e veç ekipi auditues ka marrë të dhëna për secilin projekt;

(i) në rastet kur investimet kanë qenë të realizuara nga burimet vetanake të kompanisë janë shtypur kartelat nga moduli i kontabilitetit me çka është hequr mëdyshja e shumave të deklaruara, (ii) ndërsa për investimet nga donacionet janë marrë kontratat apo faturë si dhe janë kontrolluar nëse shuma e investimeve të tilla janë futur në modulin e aseteve të kompanisë.

Çështja e regjistrimit të projekteve të tilla të financuara nga donatorët është përcjell në vazhdimësi me vështirës, pasi që dhuruesit e tyre në shumicën e rasteve kanë hezituar të ofrojnë informatat e plota të kërkuara nga kompanitë për regjistrimin e tyre të plotë. Vetëm tani, kohëve të fundit kjo praktik është duke u korrigjuar dhe po korrigjohet dhe është në rrugë të mbarë përfundimisht të zgjidhet. Për këtë, nuk duhet nënvlerësuar edhe neglizhencën e kompanive në kërkimin e të dhënave të tilla, për çka rregullatori ka insistuar dhe insiston në vazhdimësi.

Përveç veprimeve të lartë cekura të gjitha të dhënat e deklaruar në këtë raport para së atë të përmbillen u janë dërguar edhe njëherë kompanive përkatëse për tu verifikuar, me që rast u janë kërkuar komente për mos akordimin eventual të tyre.

Në dy raste kemi marr disa komente të cilat i kemi verifikuar dhe në fund kanë dalë të dhënat e akorduara e ato janë me KRU Hidroregjioni-Jugor” sh.a-Prizren dhe KRU “Mitrovica” sh.a-Mitrovicë.

Prandaj, të dhënat e deklaruara në raport janë të mirëqena dhe për ne konsiderohen si të përmbyllura.

Tabela Nr. 6. Pasqyra e investimeve kapitale të planifikuara, të lejuara nga DFTRR/ZRRUM dhe të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2010

Emri Kompanisë	Kategoria e Investimeve	Investimet Kapitale të planifikuara për Ujë			Investimet kapitale të planifikuara për Kanalizim			Shuma e Investimeve të planifikuara nga kompania për 2010 €	Investimeve vetanake te lejuara me tarifen e vitit 2010 €	Investimet e realizuara gjatë vitit 2010 për Ujë		Investimet e realizuara gjatë vitit 2010 për Kanalizim	
		Vetanake €	Donacione €	Totali €	Vetanake €	Donacione €	Totali €			Vetanake €	Donacione €	Vetanake €	Donacione €
"Prishtina" Sh.A. Prishtinë	Infrastrukturë	1,234,700	7,532,000	8,766,700	77,000	1,000,000	1,077,000	9,843,700	2,926,934	186,830.59	119,478.00	-	-
	Jo-Infrastrukturë	1,315,800	14,541,340	15,857,140	400,000	4,700,000	5,100,000	20,957,140		367,033.96	138,473.00	-	-
	Totali	2,550,500	22,073,340	24,623,840	477,000	5,700,000	6,177,000	30,800,840		553,864.55	257,951.00	-	-
"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë	Infrastrukturë	210,900	313,300	524,200	8,700	71,000	79,700	603,900	444,461	25,433.28	397,098.00	-	-
	Jo-Infrastrukturë	414,600	131,000	545,600	8,000	-	8,000	553,600		7,965.00	19,845.00	-	-
	Totali	625,500	444,300	1,069,800	16,700	71,000	87,700	1,157,500		33,398.28	416,943.00	-	-
"Hidrodrini" Sh.A. Pejë	Infrastrukturë	523,500	260,000	783,500	413,700	20,000	433,700	1,217,200	687,137	44,162.80	1,242,415.00	1,591.00	-
	Jo-Infrastrukturë	165,000	-	165,000	140,000	-	140,000	305,000		36,292.00	62,570.38	-	-
	Totali	688,500	260,000	948,500	553,700	20,000	573,700	1,522,200		80,454.80	1,304,985.38	1,591.00	-
"Hidrosistemi Radoniqi" Sh.A. Gjakovë	Infrastrukturë	141,300	350,000	491,300	50,025	-	50,025	541,325	1,142,693	24,498.00	103,740.23	-	-
	Jo-Infrastrukturë	620,000	2,200,000	2,820,000	-	-	-	2,820,000		24,524.12	-	-	-
	Totali	761,300	2,550,000	3,311,300	50,025	-	50,025	3,361,325		49,022.12	103,740.23	-	-
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren	Infrastrukturë	241,900	2,014,580	2,256,480	227,200	5,178,647	5,405,847	7,662,327	712,997	12,918.00	1,107,974.00	-	-
	Jo-Infrastrukturë	173,700	79,779	253,479	50,000	4,500,000	4,550,000	4,803,479		69,907.60	87,055.00	-	-
	Totali	415,600	2,094,359	2,509,959	277,200	9,678,647	9,955,847	12,465,806		82,825.60	1,195,029.00	-	-
"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj	Infrastrukturë	485,000	425,000	910,000	229,500	-	229,500	1,139,500	933,177	37,407.02	212,623.00	5,751.59	1,097,405.00
	Jo-Infrastrukturë	235,000	-	235,000	35,500	-	35,500	270,500		17,576.55	-	1,154.23	-
	Totali	720,000	425,000	1,145,000	265,000	-	265,000	1,410,000		54,983.57	212,623.00	6,905.82	1,097,405.00
"Hidromorava" Sh.A. Gjiilan	Infrastrukturë	20,050	-	20,050	20,100	-	20,100	40,150	395,865	36,656.00	221,144.00	-	-
	Jo-Infrastrukturë	335,800	100,000	435,800	-	-	-	435,800		-	-	-	-
	Totali	355,850	100,000	455,850	20,100	-	20,100	475,950		36,656.00	221,144.00	-	-
Totali i investimeve		6,117,250	27,946,999	34,064,249	1,659,725	15,469,647	17,129,372	51,193,621	7,243,264	891,204.92	3,712,415.61	8,496.82	1,097,405.00

Tabela Nr. 6.a. Pasqyra e shumës së investimeve **vetanake** të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara prej ZRRUM për vitin 2010, si dhe të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2010

INVESTIMET VETANAKE						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë vitit 2010	Përqindja e realizimit të caktut	Vlerësimi përfundimtar vjetor
		€	€	€	%	
1	Prishtina	3,027,500	2,926,934	553,865	18.92%	Negativ
2	Mitrovica	642,200	444,461	33,398	7.51%	Negativ
3	Hidrodrini	1,242,200	687,137	82,046	11.94%	Negativ
4	Radoniqi	811,325	1,142,693	49,022	4.29%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	692,800	712,997	82,826	11.62%	Negativ
6	Bifurkacioni	985,000	933,177	61,889	6.63%	Negativ
7	Hidromorava	375,950	395,865	36,656	9.26%	Negativ
	Totali	7,776,975	7,243,264	899,702	12.42%	Negativ

Tabela Nr. 6a. pasqyron saktë shkallën e realizueshmërisë së investimeve kapitale të financuara veç e veç nga mjetet vetanake të kompanive dhe të sektorit në përgjithësi.

Siç edhe mund të shihet të gjitha KRU-të kanë qenë shumë ambicioze gjatë aplikimit për procesin tarifor të viteve 2009-2011, pasi që kanë paraqitur shuma të mëdha të investimeve kapitale për realizim të cilat nuk kanë mund as për së afërmi me i realizuar gjatë vitit 2010 e as gjatë vitit paraprak 2009. Në nivel sektori vlera absolute e aprovuar për relizim gjatë vitit ka qenë 7,243,264 € dhe janë realizuar vetëm 899,702 € .

Në nivel sektori shkalla e realizimit të investimeve kapitale nga burimet vetanake është realizuar në masën prej vetëm 12.42 % të shumës së përgjithshme të investimeve të planifikuara për tu realizuar, e cila shumë është shumë të ulët dhe për këtë kompanitë nuk do duhej të kishin ndonjë justifikim.

Shprehur në % shkalla e realizimit të projekteve investive kapitale në nivel sektori nga burimet e brendshme të financimit ka qenë vetëm 12.42%

Tabela Nr. 6.b. Pasqyra shumëse së investimeve të planifikuara nga donatorët dhe KRU-të për realizim dhe të aprovuara nga ZRRUM për vitin 2010, si dhe shkallën e realizueshmërisë së tyre gjatë vitit 2010

INVESTIMET E PLANIFIKUARA PER REALIZIM NGA DONATORËT						
Nr	Emri i Kompanive	Investimet e planifikuara për 2010	Investimet e lejuara për 2010	Investimet e realizuara gjatë vitit 2010	Përqindja e realizimit të cakt	Vlerësimi përfundimtar vjetor
		€	€	€	%	
1	Prishtina	27,773,340	27,773,340	257,951	0.93%	Negativ
2	Mitrovica	515,300	515,300	416,943	80.91%	Negativ
3	Hidrodrini	280,000	280,000	1,304,985	366.07%	Pozitiv
4	Radoniqi	2,550,000	2,550,000	103,740	4.07%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	11,773,006	11,773,006	1,195,029	10.15%	Negativ
6	Bifurkacioni	425,000	425,000	1,310,028	208.24%	Pozitiv
7	Hidromorava	100,000	100,000	221,144	121.14%	Pozitiv
	Totali	43,416,646	43,416,646	4,809,821	11.08%	Negativ

Investimet nga donatorët e ndryshëm nuk ndikojnë në lartësinë e tarifës, por ato si të tilla monitorohen nga ZRRUM. Disa kompani kanë tejkaluar parashikimet e tyre në aspektin e investimeve nga donatorët, siç janë: Hidrodrini, Bifurkacioni dhe Hidromorava.

Kurse KRU-të tjera nuk kanë arritur ti realizojnë investimet kapitale nga donatorët sipas planifikimeve të parapara, në këtë kontekst duhet potencuar se realizimi i këtyre investimeve nuk varet plotësisht nga KRU-të.

Disa projekte ose të dhëna për vitin 2010 mund të jenë bartë nga financimet e projekteve të tilla të filluara për realizim edhe gjatë vitit 2009

4.2. Krahësimi i Investimeve Kapitale me caqet e përcaktuara nga ZRRUM

Disa komente të shkurta për projektet e realizuara/mos realizuara gjatë vitit 2010.

KRU “Prishtina” Sh. a – Prishtinë, gjatë vitit 2010 ka arritur të realizoj vetëm 18.92% të investimeve kapitale prej burimeve vetanake krahasuar me shumën e lejuar për vitin 2010. Kurse, prej Donacioneve gjatë kësaj periudhe kohore kanë realizuar investime në vlerë prej 257,951 €, e cila në raport me planifikimet përbën 0.93 % të shumës së projekteve të planifikuara për realizim.

KRU “Mitrovica” Sh. a – Mitrovicë, gjatë vitit 2010 ka realizuar investime kapitale nga burimet vetanake të kompanisë në vlerë prej 33,398 €, shprehur në përqindje paraqet 7.51 % krahasuar me shumën e lejuar nga ZRRUM. Në kategorinë e investimeve nga Donatorët kjo kompani nuk qëndron keq, pasi që ka arritur ti afrohet shumës së planifikuar dhe atë në vlerë prej 80,91%.

KRU “Hidrodrini” Sh. a – Pejë, kjo kompani gjatë vitit 2010 nga burimet vetanake të kompanisë ka arritur ti realizoj investime në vlerë prej vetëm 82,046 €, shifër kjo e cila është larg përmbushjes së cakut të përcaktuara nga ZRRUM. Për vitin 2010 ZRRUM ka aprovuar 687,137 € nga burimet vetanake, ndërsa kompania ka arritur të realizoj vetëm 82,046 € ose 11.94 % të vlerës së aprovuar.

Në kategorinë e investimeve nga donacionet kjo kompani ka tejkaluar shumë e projektuar dhe të aprovuar nga ZRRUM, e cila shprehur në përqindje është 366,07% ma e lartë se ajo e planifikuar.

KRU “Radoniqi” Sh .a – Gjakovë, edhe kjo kompani gjatë vitit 2010 ka realizuar një shumë minore të investimeve prej burimeve financiare vetanake dhe atë prej vetëm 4.29% krahasuar me shumë e lejuar gjatë gjithë vitit 2010. Po ashtu edhe në kategorinë e investimeve nga donatorët kjo kompani ka realizuar shumë të vogël të investimeve dhe atë në vlerë prej 4.07% krahasuar me planifikimet.

KRU “Hidroregjioni-Jugor” Sh. a – Prizren, gjatë vitit 2010 ka arritur të realizoj 11.62% të investimeve nga burimet vetanake të kompanisë krahasuar me shumë e lejuar nga ZRRUM. Kurse nga donacionet kanë arritur të investojnë 10.15% krahasuar me planifikimet.


KRU “Bifurkacioni” Sh. a – Ferizaj, edhe kjo kompani gjatë vitit 2010 ka realizuar një shumë minore të investimeve kapitale nga burimet financiare të kompanisë, e cila shprehur në përqindje paraqet 6.63% të shumës së aprovuar nga ZRRUM. Kurse në kategorinë e investimeve të financuara nga Donatorët kjo kompani ka tejkaluar shumë e planifikuar, ku përqindja e realizimit është 308.24%.

KRU “Hidromorava” Sh. a – Gjilan, gjatë vitit 2010 ka rritur të realizoj 9.26 % të investimeve të financuara nga burimet vetanake të kompanisë krahasuar me shumë e lejuar nga ZRRUM për të njëjtin vit. Ndërsa në kategorinë e investimeve nga Donatorët kjo kompani ka tejkaluar shumë e planifikuar, ku përqindja e realizimit ka arrit të jetë ma lartë për 221.14%.


4.2. Paraqitja grafike e investimeve kapitale

Diagramet e mëposhtme shprehin në mënyrë grafike investimet e planifikuar, aprovuar dhe të realizuara nga burimet vetanake si dhe të atyre prej donacioneve, si të tilla do të paraqiten pa bërë ndonjë komentim nga ZRRUM.

Diagrami Nr. 12. Shuma e investimeve vetanake të planifikuara, lejuara dhe realizuara



Diagrami Nr. 13. Shuma e investimeve të planifikuara, lejuara dhe realizuara nga donacionet



KONKLUZIONE

Nga të dhënat e këtij raporti mund të nxirren disa konkluzione të cilat janë përshkruar edhe në pjesë të caktuar të tekstit paraprakë. Sidoqoftë është mirë të përkujtojmë faktin se kompanitë në përgjithësi kanë dështuar në përmbushjen e synimeve të veta të cilat bartën nga viti në vit.

Njohurit tona për sektorin të cilin e kemi në kompetencë për ta rregulluar, konfirmojnë bindjen tonë se kompanitë në përgjithësi Planet Biznisore të tyre i kanë bazuar ma tepër në vullnetin e mirë pa potencial të mjaftueshëm kuadrovik dhe financiarë për ti realizuar dhe për shkak të ndikimeve jashtë kompetencave të tyre.

Kompanitë duhet të angazhohen për të përgatit dhe përpiluar plane të bazuara dhe të qëndrueshme duke u mbështet në të dhëna reale ekzistuese të brendshme dhe ato të pritshme nga jashtë.

Shpresojmë se këtu e tutje dhe sidomos për procesin tarifarë 2012-2014 ato do të jenë më të përmbajtura dhe ma realiste dhe se do të kenë mësuar nga përvojat e kaluara se format e tilla të planifikimit janë të tejkaluara dhe se do të kenë qasje realiste.